



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

PROJEKTLIGJI PËR METROLOGJI

DRAFTLAW ON METROLOGY

NACERTZAKONA ZA METROLOGIJU

<p style="text-align: center;">REPUBLIKA E KOSOVËS KUVENDI</p> <p>Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,</p> <p>Miraton</p> <p style="text-align: center;">LIGJIN PËR METROLOGJI</p> <p style="text-align: center;">Neni 1 Qëllimi</p> <p>Me këtë ligj rregullohet sistemi i njëjësive matëse, etalonët për matje, procedurat e vlerësimit të konformitetit të mjeteve matëse, kërkesat metrologjike për produktet e parapaketuara, autorizimet në fushën e metrologjisë, mbikëqyrjen metrologjike si dhe përgjegjësitë e Departamentit të Metrologjisë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 2 Fusha e zbatimit</p> <p>Ky ligj zbatohet në fushat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe kafshëve, mbrojtjen e konsumatorit,</p>	<p style="text-align: center;">THE REPUBLIC OF KOSOVO THE ASSEMBLY</p> <p>Pursuant to article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo,</p> <p>Approves</p> <p style="text-align: center;">LAW ON METROLOGY</p> <p style="text-align: center;">Article 1 Objective</p> <p>The objective of this law is to regulate the system of measuring units, measuring etalons, procedures for assessment of the conformity of measuring units, metrological requirements for pre-packaged products, authorization in the field of metrology, metrological observation as well as responsibilities of Metrology Department.</p> <p style="text-align: center;">Article 2 Field of implementation</p> <p>This law is implemented in the fields which especially deal with: protection of the human and animal health, protection of the</p>	<p style="text-align: center;">REPUBLIKA KOSOVO SKUPŠTINA</p> <p>U podršci članu 65 (1) Ustava Republike Kosova,</p> <p>Odobrava</p> <p style="text-align: center;">ZAKON ZA METROLOGIJU</p> <p style="text-align: center;">Član 1 Cilj</p> <p>Ovaj zakon ima za cilj regulisanje sistema mernih jedinica, etalona za merenja, procedure procene usklađivanje mernih aparata, metroloških zahteva za pre-pakirane proizvode, ovlašćenje na polju metrologije, metroloških nadzor, ka i odgovornosti departamenta metrologije.</p> <p style="text-align: center;">Član 2 Polje primene</p> <p>Ovaj zakon se primenjuje na poljima koja imaju veze, sa zaštitom zdravlja ljudi i stoke, zaštitom potrošača, sredine i opšte</p>
---	---	---

<p>mjedisit dhe sigurisë se përgjithshme teknike, transaksionet e mallrave dhe shërbimeve.</p>	<p>consumer, environment and general technical safety goods and services transactions.</p>	<p>tehničke sigurnosti, transakcije roba i usluga.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 3 Përkufizime</p>	<p style="text-align: center;">Article 3 Definitions</p>	<p style="text-align: center;">Član 3 Odrednice</p>
<p>1. Në kuptim të këtij ligji shprehjet e përdorura në vijim kanë këto kuptime:</p>	<p>1. For the purposes of this Law the following definitions shall apply:</p>	<p>1. U shvatanju ovog zakona, izrazi korišćeni u nastavku imaju sledeća značenja:</p>
<p>1.1. Ministria - nënkupton Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.</p>	<p>1.1. Ministry - shall mean the Ministry of Trade and Industry.</p>	<p>1.1. Ministarstv - podrazumeva Ministarstvo Trgovine i Industrije.</p>
<p>1.2. Ministër - nënkupton Ministrin e Ministrisë të Tregtisë dhe Industrisë.</p>	<p>1.2. Minister - shall mean the Minister of the Ministry of Trade and Industry.</p>	<p>1.2. Ministar - je Ministar Ministarstva Trgovine i Industrije.</p>
<p>1.3. Metrologji - nënkupton shkencën e matjeve.</p>	<p>1.3. Metrology - shall mean the science of measurement.</p>	<p>1.3. Metrologija - podrazumeva nauku merila/merenja.</p>
<p>1.4. Matje - nënkupton serinë e veprimeve për përcaktimin e vlerës së një madhësie.</p>	<p>1.4. Measurement - shall mean a series of actions undertaken to determine the value of a size.</p>	<p>1.4. Merenje - predstavlja seriju akcija za određivanje vrednosti jedne veličine.</p>
<p>1.5. Njësi matëse - nënkupton madhësinë e caktuar, e pranuar me marrëveshje, për të shprehur në mënyrë sasiore madhësi të tjera të së njëjtës natyrë.</p>	<p>1.5. Measuring unit - shall mean the specified size accepted by agreement, which is used to quantitatively express other sizes of the same nature.</p>	<p>1.5. Merna jedinica - predstavlja određenu veličinu, prihvaćenu sporazumom, da bi izrazila na količinski način druge veličine iste prirode.</p>
<p>1.6. Mjet matës - nënkupton çfarëdo pajisje apo instrument matës, sistem me funksione matëse si dhe materialet referente.</p>	<p>1.6. Measuring device - shall mean any measuring equipment or instrument, measuring function system and reference materials.</p>	<p>1.6. Merni instrument - predstavlja bilo koju opremu ili merni instrument, sistem sa mernim funkcijama kao i referentne materijale.</p>

<p>1.7. Tipi i mjetit matës - nënkupton serinë e mjeteve matëse, me funksion identik, bazuar në të njëjtin parim, që kanë të njëjtin projekt dhe që janë prodhuar nga i njëjti prodhues, në bazë të njëjtit dokumentacion teknik dhe teknologjik.</p> <p>1.8. Etalon matjeje - nënkupton masë matjeje, mjet matës, sistem matës ose material referent i përcaktuar të realizojë, të ruajë ose të riprodhojë një njësi ose më shumë vlera të një madhësie, për t'i transmetuar ato, me anë të krahasimeve me mjete të tjera matëse.</p> <p>1.9. Etalon shtetëror i matjeve - nënkupton një etalon i deklaruar nga Departamenti i Metrologjisë të Kosovës dhe miratuar nga Ministri për të shërbyer në Republikën e Kosovës si bazë për përcaktimin e vlerave të etalonëve të tjera të madhësisë përkatëse.</p> <p>1.10. Etalon referent - nënkupton etalonin që ka cilësinë më të lartë metrologjike në një vend apo organizatë të dhënë, nga i cili rrjedhin matjet e bëra.</p> <p>1.11. Ruajtje e etalonit të matjes - nënkupton të gjitha veprimet e nevojshme për të ruajtur karakteristikat metrologjike</p>	<p>1.7. Type of measuring device - shall mean a series of measuring units with identical function, based on the same principle, which have the same project and produced by the same manufacturer based on the same technical documentation and technology.</p> <p>1.8. Measuring etalon - shall mean a measuring size, measuring device, measuring system or reference material designated to achieve, save or reproduce a unit or additional size values, to transmit them by way of comparing with other measuring devices.</p> <p>1.9. State measuring etalon - shall mean an etalon announced by the Kosova Metrology Department and adopted by the Minister which will serve in the Republic of Kosova as the basis for determination of other corresponding size etalons.</p> <p>1.10. Reference etalon - shall mean an etalon which in general has the highest metrological quality in a given country or organization from which performed measurements derive.</p> <p>1.11. Protection of measuring etalon - shall mean all the necessary actions to preserve metrological characteristics of the</p>	<p>1.7. Tip mernog instrumenta - predstavljaju jednu seriju mernih instrumenata, sa identičnom funkcijom, zasnovan na istom principu, koji imaju isti projekat i koji su proizvedeni od istog proizvođača, na osnovu iste tehničke dokumentacije i tehnologije.</p> <p>1.8. Merni Etalon - predstavlja mernu masu, merni instrument, merni sistem ili referentni materijal određen da realizuje, sačuva ili da ponovno proizvede jednu jedinicu ili više vrednosti jedne veličine, da bi ih transmitovala putem upoređivanja, sa drugim mernim instrumentima.</p> <p>1.9. Državni merni Etalon - predstavlja jedan etalon deklarisan od strane Departamenta Metrologije Kosova i odobrenu od strane Ministra kako bi služila u Republici Kosovo kao jedna osnova za određivanje vrednosti drugih etalona određene veličine.</p> <p>1.10. Referentni Etalon - predstavlja jedan etalon koji uopšteno, ima najviše metrološko svojstvo u jednoj zemlji ili organizaciji, iz koje proizilaze napravljena merenja.</p> <p>1.11. Čuvanje mernog etalona - su sve potrebne akcije potrebne za očuvanje metroloških karakteristika mernog etalona,</p>
---	--	--

<p>të etalonit të majtës, brenda kufijve të caktuar.</p> <p>1.12. Material referent - nënkupton materialin ose substancën me homogjenitet të mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm, për një apo më shumë cilësi, i përdorur në kalibrim, për përcaktimin e vlerës së një materiali tjetër ose për sigurimin e cilësisë.</p> <p>1.13. Material referues i certifikuar - nënkupton materialin referues, i shoqëruar me dokumentacion të lëshuar nga organi kompetent dhe konform procedurave, të përdorura për të shtuar vlera cilësore specifike me pasiguri dhe gjurmueshmëri metrologjike.</p> <p>1.14. Transmetueshmeri (Gjurmueshmëri) - nënkupton cilësinë e rezultatit matës përmes së cilit rezultati krijon lidhje me etalonin referent zakonisht etalonit shtetëror ose ndërkombëtar nëpërmjet të zinxhirit të pa këputur të kalibrimit të dokumentuar, ku secili kontribon në pasigurinë matëse.</p> <p>1.15. Kalibrim - nënkupton serinë e veprimeve në kushte të veçanta që përcakton marrëdhënien ndërmjet vlerave të treguara nga mjeti matës ose sistemi</p>	<p>measuring etalon within the specified limits.</p> <p>1.12. Reference material - shall mean a material or substance with an adequate and sustainable homogeneity, for one or more qualities, used in calibration, for determination of the value of another material or to ensure the quality.</p> <p>1.13. Certified reference material - shall mean a reference material accompanied by documentation issued by competent bodies in conformity with valid procedures, used to add specific quality values with uncertainty and metrological research.</p> <p>1.14. Transmittance - shall mean the quality of the measurement result through which the result creates a link to the reference etalon (usually state or international etalon) through an unbroken chain of documented calibration, where each one contributes to measurement uncertainty</p> <p>1.15. Calibration - shall mean a series of actions under special conditions which determine the relationship between values displayed on the measuring device and</p>	<p>unutar određenih granica.</p> <p>1.12. Referentni materijal - predstavlja jedan materijal ili supstancu sa dovoljnom i održivom homogenošću, za jednu ili više svojstva, upotrebljen pri kalibriranju, za određivanje vrednosti jednog drugog materijala ili za osiguranje kvaliteta.</p> <p>1.13. Referentni certifikovani materijal - je jedan referentni materijal, praćen dokumentacijom izdatom od strane kompetentnih organizama i u saglasnosti sa važećim procedurama, korišćenih za dodavanje kvalitetnih specifičnih vrednosti sa metrološkom nesigurnošću i istraživanjem.</p> <p>1.14. Transmitivnost (Istraživanje) - je svojstvo mernog rezultata putem kojeg rezultat stvara vezu sa referentnim etalom (obično državnim ili međunarodnim etalom) preko dokumentovanog neprekinutog lanca kalibriranja, gde svako doprinosi mernoj nesigurnosti.</p> <p>1.15. Kalibriranje - predstavlja seriju akcija u posebnim uslovima koje određuje odnose između pokazanih vrednosti od strane mernog instrumenta ili mernog</p>
---	---	--

<p>matës dhe vlerës korresponduese të realizuar nga etaloni i matjes.</p> <p>1.16. Verifikimi - nënkupton konfirmimin nëpërmjet ekzaminimit dhe evidentimit nëse janë plotësuar kërkesat specifike, tekniko-metrologjike.</p> <p>1.17. Certifikim - nënkupton veprimtarinë nga një pale e tretë e pavarur, qe dëshmon zyrtarisht se një produkt, proces apo shërbim është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në aktet nënligjore të këtij ligji ose konform standardeve të përcaktuara.</p> <p>1.18. Testim - nënkuptohet ekzaminimi i instrumentit, sistemit matës dhe përcaktimi i konformitetit të tyre me kërkesat specifike, ose mbi bazën e një vlerësimi profesional, me kërkesa të përgjithshme.</p> <p>1.19. Shenja e konformitetit - nënkupton shenjën dalluese e cila vendoset mbi një produkt ose ambalazhin e tij, për të dëshmuar se produkti i plotëson kriteret e vendosura sipas specifikimeve teknike.</p> <p>1.20. Vlerësim i konformitetit - nënkupton çdo veprim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që përcakton plotësimin e</p>	<p>corresponding value achieved by measuring etalon.</p> <p>1.16. Verification - shall mean confirmation by way of examination and evidencing on whether specific technical metrological requirements have been fulfilled.</p> <p>1.17. Certification - shall mean the activity through which a third independent party officially proves that a product, process or service is in compliance with requirements specified on sub-law acts of this law or in compliance with specified standards.</p> <p>1.18. Test - shall mean examination of the instrument, measuring system and determination of their conformity with specific requirements, or, based on a professional assessment, with general requirements.</p> <p>1.19. Conformity sign - shall mean a discernible sign which is affixed to a product or its packaging to prove that the product meets criteria as defined in technical specifications.</p> <p>1.20. Conformity assessment - shall mean any direct or indirect action which determines fulfilment of technical</p>	<p>sistema i odgovarajućoj meri realizovanoj od strane mernog etalona.</p> <p>1.16. Verifikacija - je potvrđivanje putem ispitivanja i evidentiranja ako su ispunjeni posebni tehničko-metrološki zahtevi.</p> <p>1.17. Certifikacija - predstavlja delatnost putem koje treća i nezavisna stranka, zvanično svedoči da je jedan proizvod, proces ili usluga u saglasnosti sa određenim zahtevima u pravnim aktima ovog zakona ili u saglasnosti sa određenim standardima.</p> <p>1.18. Testiranje - predstavlja ispitivanje instrumenta, mernog sistema i određivanje njihove usklađivanje sa specifičnim zahtevima, ili na osnovu jedne profesionalne procene, sa opštim zahtevima.</p> <p>1.19. Oznaka usklađivanje - predstavlja oznaku razlikovanja, koja se postavlja na jedan proizvod ili njegovu ambalažu, za svedočenje da proizvod ispunjava postavljene zahteve prema tehničkim specifikacijama.</p> <p>1.20. Procena usklađivanje - predstavlja svaku direktnu ili indirektnu akciju, koja određuje ispunjavanje celokupnih</p>
--	---	---

<p>tërësisë së kërkesave teknike të përcaktuara për produkte, shërbime apo procesi.</p> <p>1.21. Parapaketimi - nënkupton kombinimin e një produkti dhe një paketimi individual. Një produkt është i para-paketuar kur ai vendoset në paketim të çfarëdo natyre qoftë pa prezencën e konsumatorit dhe sasia e produktit që përmban në paketim ka një vlerë të paracaktuar dhe nuk mund të ndryshohet pa hapje dhe modifikim të dukshëm.</p> <p>1.22. Shishja, si enë matëse - nënkupton çfarëdo enë mbushëse prej qelqi ose ndonjë materiali tjetër me një fortësi dhe qëndrueshmëri jo lehtë modifikuese të projektuar për t'u taposur, që destinohet për magazinim, transport ose shpërndarje të lëngjeve e që ka karakteristika metrologjike të tilla, që mund të përdoren si shishe matëse.</p> <p>1.23. Matje zyrtare - nënkupton një matje të kryer nga Departamenti i Metrologjisë ose nga subjekti i autorizuar, në përputhje me vendimin për autorizim. Matja zyrtare përdoret si evidencë e besueshme në procedurat dhe vendimmarrjet e organit Qeveritar apo të Gjykatave.</p>	<p>requirements on product, services or process that are documented in corresponding documentation.</p> <p>1.21. Pre-packaging - shall mean combination of a product and individual packaging. A product is packaged when it is placed in a package of any nature without the presence of the consumer and the quantity of the product contained in the package has a predetermined value and it cannot be changed without opening it and noticeable modification.</p> <p>1.22. Bottle, as a measuring vessel - shall mean any filling container made of glass or other material with hard-to-modify strength and durability designed to be closed with stoppers, intended for storage, transportation or distribution of liquids, and which has such metrological characteristics that allows to be used as measuring bottles.</p> <p>1.23. Official measurement - shall mean a measurement performed by Metrological department or an authorized legal entity in compliance with the administrative decision for authorization. Official measurement is used as a reliable proof in decision making procedures by government bodies or courts.</p>	<p>tehničkih zahteva za proizvoda, usluga ili procesa</p> <p>1.21. Pre-paketiranje - je kombinacija jednog proizvoda i jednog individualnog pakovanja. Jedan proizvod je pre-paketiran kada se on postavi u paket bilo koje prirode bez prisustva potrošača i količina proizvoda koja je sadržana u paketu ima jednu predodređenu vrednost i ne može se zameniti bez vidnog otvaranja i modifikovanja.</p> <p>1.22. Flaša, kao merni sud - je bilo koji sud koji se može napuniti, od stakla ili drugog materijala sa jednom čvrstinom i izdržljivošću koja se ne može lako modifikovati i projektovanu za zatvaranje, koja je određena za magaziniranje, transport ili raznošenje tečnosti, a koja ima takve metrološke karakteristike, koja se može koristiti kao merna flaša.</p> <p>1.23. Službeno merenje - je merenje izvršeno od strane departamenta Metrologije ili od strane ovlašćene lica, u saglasnosti sa administrativnom odlukom za ovlašćenje. Službeno merenje se koristi kao verodostojni dokaz u procedurama i pri donošenju odluka državnih organa ili sudova.</p>
--	---	---

<p>1.24. Miratim i tipit të instrumenteve matëse - nënkupton pranimin e instrumenteve matëse për verifikim fillestar dhe kur kjo e fundit nuk kërkohet, atëherë lëshohet autorizimi për t'i hedhur ato në treg dhe/ose për t'i vënë në përdorim.</p> <p>1.25. Lejim për hedhje në treg ose vënie në përdorim të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara - nënkupton lejen e dhënë nga Departamenti i Metrologjisë të Kosovës për hedhjen në treg ose vënien në përdorim të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, të cilat nuk kanë shenjën e verifikimit fillestar.</p> <p>1.26. Furnitor - nënkupton prodhuesin e produktit të regjistruar në Kosovë dhe çdo person tjetër që paraqitet si prodhues i cili vendos në produkt emrin, shenjën mbrojtëse të tij apo ndonjë shenjë tjetër dalluese ose përpunon në tërësi produktin, përfaqësuesin e prodhuesit kur prodhuesi nuk është i regjistruar në Kosovë ose kur nuk ka përfaqësues të regjistruar në Kosovë, importuesin e produktit, si dhe personat tjerë në hallkën e furnizimit, në masën në të cilën veprimtaritë e tyre mund të ndikojë në karakteristikat e sigurisë së produktit.</p>	<p>1.24. Approval of measuring instruments type - shall mean acceptance of these instruments for initial verification, and, when the latter is not required, then issued authorization to make them available on the market and/or to put them to use.</p> <p>1.25. Permission to make available on the market or putting to use legally inspected measuring instruments - shall mean the permission issued by Kosova Metrological departmenta to make available on the market or putting to use legally inspected measuring instruments which do not have the sign of initial verification.</p> <p>1.26. Supplier - shall mean the manufacturer of the product when it is registered in Kosova and any other person who is presented as manufacturer and who attaches to the product name, his protective sign or any other discernable sign, or thoroughly processes the product, the representative of the manufacturer when the manufacturer is not registered in Kosova or when it does not have registered representatives in Kosova, product importer, other persons in the supply chain, to the extent that their activities may affect safety characteristics of the product.</p>	<p>1.24. Odobrenje tipa mernih instrumenata - je prihvatanje ovih instrumenata za početnu verifikaciju i, kada se ovo poslednje ne traži, onda se izdaje ovlašćenje da se one postave na tržište i/ili da se stave u upotrebu.</p> <p>1.25. Dozvola za postavljanje na tržište ili stavljanje u upotrebu zakonski kontrolisanih mernih instrumenata - je dozvola izdata od strane departamenta Metrologije Kosova, za postavljanje na tržište ili stavljanje u upotrebu mernih instrumenata zakonski kontrolisanih, koje nemaju oznaku početne verifikacije.</p> <p>1.26. Dobavljač - podrazumeva proizvođača proizvoda kada je on registrovan na Kosovu i svaka druga osoba koja se predstavlja kao proizvođač koji na proizvod postavlja ime, njegov zaštitni znak ili neki drugi znak raspoznavanja, ili temeljno preraduje proizvod, predstavnik proizvođača kada proizvođač nije registrovan na Kosovu, uvoznik proizvoda, druge osobe u lancu nabavke, u meri u kojoj njihove delatnosti mogu uticati na karakteristike sigurnosti proizvoda.</p>
--	---	--

<p>1.27. Autorizim - nënkupton dhënien e të drejtës, për të kryer verifikimin dhe kalibrimin e mjetit matës në fushën e subjekteve që kryejnë veprimtari në Kosovë.</p> <p>1.28. Subjekti i autorizuar - nënkupton personin fizik dhe juridik i cili kryen detyra ne fushën e metrologjisë.</p> <p>1.29. Inspektim - nënkupton mbikëqyrjen metrolgjike të një produkti, shërbimi, procesi ose të një sistemi matës, sipas kërkesave te caktuara ose në bazë të një gjykimi profesional.</p> <p>2. Nëse shprehjet dhe përkufizimet nuk janë të përcaktuara në nenin 2 të këtij ligji dhe dispozita ne zbatim te tij, vlejné - përdoren termat nga fjalori ndërkombëtar i terminologjisë bazike dhe të përgjithshme të metrologjisë VIM-Internacional Vocabulary of Metrology - Basic and general Concepts and Associated Terms in Metrology dhe VIML-International Vocabulary of Terms in Legal Metrology.</p>	<p>1.27. Authorization - shall mean the right to perform verification and calibration of a measuring device in the mandatory field for public or private subjects, local or foreign subjects performing activities in Kosova.</p> <p>1.28 Authorized entity - shall mean a legal person and a natural person which performs duties of metrology field.</p> <p>1.29. Inspection - shall mean metrology surveillance of a product, service, and process or of a measuring system based to the specific requirements and/or professional judgment.</p> <p>2. If expressions and definitions are not specified under Article 2 of this Law and provisions for its implementation, then terms from VIM-International Vocabulary of Metrology - Basic and general Concepts and Associated Terms in Metrology and VIML - International Vocabulary of Terms in Legal Metrology shall be used.</p>	<p>1.27. Olašćenje - predstavlja davanje prava za vršenje verifikacije i kalibriranje mernog instrumenta u polju, subjektima, koje vrše delatnost na Kosovu.</p> <p>1.28. Olašćeneno lice - podrazumeva fizičko ili pravno lice koji obavlja poslove u oblasti metrologije.</p> <p>1.29. Inspekcija - podrazumeva metrološki nadzor proizvoda, usluga, procesa ili sistem mjerenja, u skladu sa određenim zahtjevima, ili na osnovu profesionalne suđenje.</p> <p>2. Ako izrazi i ograničenja nisu određeni u članu 2 ovog zakona i odredbi u njegovom sprovođenju, onda se trebaju koristiti izrazi iz međunarodnog rečnika osnovne i opšte metrološke terminologije VIM - International Vocabulary of Metrology - Basic and general Concepts and Associated Terms in Metrology i VIML-International Vocabulary of Terms in Legal Metrology.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 4 Te drejtat dhe detyrat e Departamentit te Metrologjisë</p> <p>1. Departamenti i Metrologjisë është përgjegjës për zhvillim dhe mbikëqyrjen e</p>	<p style="text-align: center;">Article 4 Rights and responsibilities of the Metrology Department</p> <p>1. The Metrology Department is responsible for Metrology development and supervision</p>	<p style="text-align: center;">Član 4 Prava i obaveza Departament Metrologije</p> <p>1. Departamnet metrologije je odgovoran za razvoj i nodzor celog sistema</p>

<p>sistemit të metrologjisë në tërë territorin e Kosovës.</p> <p>2. Organizimi dhe funksionimi i Departamentit të metrologjisë dhe njërive të saj rregullohet me akt nënligjor.</p> <p>3. Departamenti kryen punë profesionale, administrative dhe organizative në fushën e metrologjisë, në kuptim të dispozitave të këtij ligji dhe ligjeve tjera.</p> <p>4. Përveç punëve të përshkruara nga paragrafi 3 i këtij neni Departamenti ka këto detyra dhe përgjegjësi:</p> <p>4.1. propozon dhe harton legjislacionin në fushën e metrologjisë;</p> <p>4.2. bashkërendon punën me organet tjera të sistemit të metrologjisë dhe mbështet zhvillimin e këtij sistemi;</p> <p>4.3. përgjigjet për etalonët shtetëror;</p> <p>4.4. mban dhe ruan disa nga etalonët shtetëror të njërive të matjes në laboratorët e saj;</p> <p>4.5. monitoron mënyrën e mbajtjes, ruajtjes dhe të përdorimit për të gjithë etalonët shtetëror të matjeve;</p> <p>4.6. organizon aktivitetet e kalibrimit në Kosovë;</p> <p>4.7. certifikon materialet referuese;</p>	<p>in all Kosovo territory.</p> <p>2. Organization and functioning of the Metrology Department and its Units will regulate bylaws.</p> <p>3. Department performs professional work as well as administrative and organizational duties in the field of metrology as provided for in the provisions of this Law and other laws.</p> <p>4. Besides duties described in paragraph 3 of this article, the department is responsible of the following duties and rights concerning metrology:</p> <p>4.1. proposes and prepares legislation in the field of metrology;</p> <p>4.2. coordinates work with other metrology system bodies and supports development of this system;</p> <p>4.3. is responsible for national etalons;</p> <p>4.4. maintains and stores at its laboratories several of the national etalons for measuring units;</p> <p>4.5. monitors the way how all the measuring etalons are maintained, stored and used;</p> <p>4.6. organizes calibration activities in Kosova;</p> <p>4.7. certifies reference materials;</p>	<p>metrologije na teritoriju Kosova.</p> <p>2. Organizacija i funkcionisanje departamenta metrologije i njenih jedinica regulišu se podzakonskim aktima.</p> <p>3. Departament vrši profesionalni posao, kao i administrativne i organizacione poslove na polju metrologije, u shvatanju odredbi ovog i drugih zakona.</p> <p>4. Osim poslova opisanih u stav 3 ovog člana, departamenta ima sledeće dužnosti i prava za metrologiju:</p> <p>4.1. predlaže i priprema zakonodavstvo na polju metrologije;</p> <p>4.2. koordiniše poslove sa drugim organima sistema metrologije i podržava razvoj ovog sistema;</p> <p>4.3. odgovorna je za nacionalne etalone;</p> <p>4.4. održava i čuva neke od nacionalnih etalona mernih jedinica u svojim laboratorijama;</p> <p>4.5. nadgleda način držanja, čuvanja i korišćenja za sve nacionalne merne etalone;</p> <p>4.6. organizuje aktivnosti kalibriranja na Kosovu;</p> <p>4.7. certifikuje referentne materijale;</p>
--	--	--

<p>4.8. kryen kontrollin ligjor të mjeteve matëse;</p> <p>4.9. kryen kontrollin sasior të produkteve të parapaketuara dhe të shisheve, si enë matëse;</p> <p>4.10. mban evidencën e të gjithë prodhuesve dhe furnitorëve të parapaketimit dhe shisheve si enë matëse;</p> <p>4.11. rekomandon dhënien e autorizimit subjekteve për verifikimin e mjeteve matëse, ekspertizën metrologjike, si dhe për riparimin e mjeteve matëse;</p> <p>4.12. kryen mbikëqyrjen metrologjike;</p> <p>4.13. kryen mbikëqyrjen e mjeteve matëse, të prodhuara në vend dhe/ose të importuara, në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi;</p> <p>4.14. përcakton rregullat dhe mënyrën për kualifikimin dhe trajnimin e personelit të saj dhe ofron kualifikime për çështje të metrologjisë për specialistët e tjerë të subjekteve të autorizuar;</p> <p>4.15. bashkëpunon me institucionet e tjera, veçanërisht me ato të infrastrukturës shtetërore të cilësisë dhe institucionet e mbrojtjes së konsumatorit;</p> <p>4.16. shërben si referencë shtetërore për sistemin shtetërore të akreditimit të laboratorëve të kalibrimit, për aftësitë dhe etalonët e matjeve;</p> <p>4.17. bashkëpunon me organet shtetërore të metrologjisë të vendeve të tjera për</p>	<p>4.8. performs legal inspection of measuring devices;</p> <p>4.9. performs quantitative inspection of pre-packaged products and bottles, as measuring vessels;</p> <p>4.10. maintain records on all manufacturers and suppliers of pre-packages and bottles, measuring vessels;</p> <p>4.11. recommends authorization issuing for legal entities for verification of measuring devices and metrological expertise, as well as to individuals or legal entities for repairing measuring devices;</p> <p>4.12. performs metrological inspection;</p> <p>4.13. implementing legal provisions in force, conducts surveillance of the market of the measuring devices, manufactured in the country and/or imported;</p> <p>4.14. determines regulations and ways for qualification and training of its personnel and offers qualifications for metrological issues to other specialists from private and public subjects;</p> <p>4.15. cooperates with other institutions, especially with institutions for national infrastructure quality and institutions for protection of the consumer;</p> <p>4.16. serves as a national reference to national system for accreditation of calibration laboratories, capabilities and measuring etalons;</p> <p>4.17. cooperates with national metrological organizations from other countries to reach</p>	<p>4.8. vrši zakonsku kontrolu mernih instrumenata;</p> <p>4.9. vrši količinsku kontrolu pre-paketovanih proizvoda i flaša, kao mernih sudova;</p> <p>4.10. drži vođenja registra proizvođača i uvoznika pred-paketovanih proizvoda i flaša, kao mernih sudova;</p> <p>4.11. preporučuje izdavanje ovlašćenja subjekata za verifikacije mernih instrumenata, metrološku ekspertizu, za opravku mernih instrumenata;</p> <p>4.12. realizuje/vrši metrološki nadzor;</p> <p>4.13. Vrši nadzor tržišta mernih instrumenata, proizvedenih u zemlji i/ili uvezenih, u sprovođenju zakonskih odredbi na snazi;</p> <p>4.14. određuje pravila i način za kvalifikovanje i treniranje svojeg osoblja, i nudi kvalifikacije za pitanja metrologije za druge specijalisteovlašćenih lica;</p> <p>4.15. saraduje sa drugim institucijama, posebno sa onima nacionalne infrastrukture kvaliteta i institucijama zaštite potrošača;</p> <p>4.16. služi kao nacionalna referenca za nacionalni sistem akreditacije laboratorija za kalibriranje, za umešnost i merne etalone;</p> <p>4.17. saraduje sa nacionalnim organima metrologije drugih zemalja za postizanje</p>
---	--	--

<p>arritjen e marrëveshjeve të njohjes së ndërsjellë në veprimtarinë e fushës përkatëse, rajonale apo ndërkombëtare, ose për të arritur marrëveshje dypalëshe;</p> <p>4.18. ofron këshillime për problemet që kanë të bëjnë me metrologjinë;</p> <p>4.19. kryen detyra tjera administrative dhe profesionale që kanë të bëjnë me metrologjinë.</p>	<p>reciprocal agreements, regional or international, for recognition in the corresponding field of activity, or to reach bilateral agreements;</p> <p>4.18. provides counselling pertinent to metrological problems;</p> <p>4.19. performs other administrative and professional duties.</p>	<p>sporazuma međusobnog priznavanja u delatnosti na datom polju, regionalnom ili međunarodnom, ili za postizanje bilateralnih sporazume;</p> <p>4.18. nudi savetovanja za probleme vezane za metrologiju;</p> <p>4.19. vrši druge administrativne i profesionalne poslove.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 5 Njësit Matëse</p>	<p style="text-align: center;">Article 5 Measuring Units</p>	<p style="text-align: center;">Član 5 Merne Jedinice</p>
<p>1. Në Republikën e Kosovës do të përdoret Sistemi Ndërkombëtar i Njësive të Matjes (SI).</p> <p>2. Me akt nënligjor përcaktohet përdorimi i njësive SI dhe njësive të tjera jashtë sistemit SI, kur ato përdoren ndërkombëtarisht dhe nuk rrjedhin drejtpërdrejt nga sistemi SI.</p>	<p>1. The International System of Units (SI) shall be used in the Republic of Kosova.</p> <p>2. Usage of SI units and other units outside of SI system shall be defined by sub-law act, when they are used internationally and do not directly come from the SI system.</p>	<p>1. U Republici Kosovo će se koristiti Međunarodni Sistem Jedinica Mera (SI).</p> <p>2. Pod-zakonskim aktom će se odrediti upotreba SI jedinica i drugih jedinica van sistema SI, kada se one koriste na međunarodnom nivou i ne proizilaze direktno iz sistema SI.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 6 Etalonët</p>	<p style="text-align: center;">Article 6 Etalons</p>	<p style="text-align: center;">Član 6 Ētaloni</p>
<p>1. Etalonët shtetëror të matjes realizohen, ruhen dhe mirëmbahen nga Departamenti, i cili siguron transmetueshmerine (gjurmueshmerine) deri të etalonët ndërkombëtare ose etalonët shtetëror të shteteve tjera.</p>	<p>1. National measuring etalons are realized, stored and maintained by the departament, which ensures transmittance to international etalons or to national etalons of other states.</p>	<p>1. Nacionalni etaloni mera se realizuju, čuvaju i održavaju od strane departamenta, koja osigurava transmitivnost (istraživost) do međunarodnih etalona ili nacionalnih etalona drugih država.</p>

<p>2. Etaloni referent te cilin e posedon, ruan dhe mirëmban subjekti i autorizuar, mund te pranohet nga Departamenti si etalon shtetëror.</p> <p>3. Departamenti mund te vendos qe etalonët e caktuar të zhvillohen dhe mirëmbahen në institucione të tjera publike apo private.</p> <p>4. Nuk është e domosdoshme qe për çdo madhësi fizike te shpallet etaloni shtetëror i matjeve.</p> <p>5. Mbajtësit e etalonëve shtetëror shpallen me vendim të drejtorit te departamentit.</p> <p>6. Me akt nënligjor përcaktohen kushtet që duhet të plotësojë një etalon referues për t'u shpallur si etalon shtetëror i matjes, kushtet për anulimin e shpalljes dhe arsyt, mirëmbajtjen e detyrueshme dhe mënyrën e përdorimit te etalonëve shtetëror të matjeve.</p>	<p>2. The reference etalon which possess, stores and maintains a legal entity may be accepted by the department as a national etalon.</p> <p>3. The Department may decide that certain etalon to be developed and maintained at the other public or private institutions.</p> <p>4. It is not necessary to declare a national measuring etalon for each physical size.</p> <p>5. Holders of national etalons are declared by the decision the head of department.</p> <p>6. Requirements which a reference etalon shall meet in order to be declared as a national measuring etalon, conditions for annulment of the declaration and reasons, required maintenance and ways of usage of national measuring etalons are determined by sub-law acts.</p>	<p>2. Referentni etalon koji ima, čuva i održava ovlašćeno lice, može se prihvatiti od strane departament kao nacionalni etalon.</p> <p>3. Departament može odlučiti da određenih etalon se razvijaju i održavaju u drugim javnim ili privatnim institucijama.</p> <p>4. Nije obavezno da se za svaku fizičku veličinu objavi nacionalni etalon merenja.</p> <p>5. Držači nacionalni etalona se objavljuju odlukom direktora departamenta.</p> <p>6. Pod-zakonskim aktom se određuju uslovi koje treba da ispuni jedan referentni etalon da bi se proglasio kao nacionalni merni etalon, uslovi za ukidanje proglašenja i razlozi, obavezno održavanje i način korišćenja nacionalnih etalona za merenje.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 7 Laboratorët e etalonëve shtetëror</p>	<p style="text-align: center;">Article 7 State etalons laboratories</p>	<p style="text-align: center;">Član 7 Laboratorije državnih etalona</p>
<p>1. Departamenti dhe subjektet që zhvillojnë, mirëmbajnë dhe përdorin etalonët shtetëror të matjeve, kryejnë detyrat e laboratorit të etalonëve shtetëror për madhësinë fizike përkatëse, si më</p>	<p>1. The department and individuals and legal entities maintain and use national etalons, perform duties of national etalons laboratory for the following corresponding physical sizes:</p>	<p>1. Departament i subjekti koji razvijaju, održavaju i upotrebljavaju nacionalne merne etalone, vrše zadatke laboratorije nacionalnih etalona za odgovarajuću fizičku veličinu, kao u nastavku:</p>

<p>poshtë:</p> <p>1.1. sigurimin e transmetueshmërisë (gjurmueshmërisë) së etalonëve shtetëror të matjeve me njësitë SI;</p> <p>1.2. përhapjen e njërive të etalonëve shtetëror të matjeve tek etalonët referuese të matjeve dhe të mjeteve matëse me anë të kalibrimit;</p> <p>1.3. sigurimin e njohjes ndërkombëtare të etalonëve shtetëror të matjeve dhe të certifikatës së kalibrimit të lëshuar;</p> <p>1.4. ndërmarrjen e masave për ruajtjen e transmetueshmërisë (gjurmueshmërisë), në rastin e dëmtimit dhe të shkatërrimit të etalonëve shtetëror të matjeve.</p> <p>2. Aftësia teknike e laboratorëve të etalonëve shtetëror të matjeve ruhet nëpërmjet pjesëmarrjes në veprimtaritë metrologjike ndërkombëtare dhe vlerësohet me akreditim apo në një mënyrë tjetër të barasvlershme.</p> <p>3. Departamenti bashkërendon veprimtaritë e laboratorëve të etalonëve shtetëror të matjeve drejt njohjes ndërkombëtare.</p> <p>4. Laboratorët e etalonëve shtetëror duhet t'i dërgojnë Departamentit të dhëna për veprimtaritë me etalonët shtetëror të matjeve, përfshirë edhe të dhënat për përdorimin e fondeve buxhetore në bazë</p>	<p>1.1. ensuring traceability of national measuring etalons with SI units;</p> <p>1.2. dissemination of the units of national measuring etalons to reference measuring etalons and measuring devices by way of calibration;</p> <p>1.3. ensuring international recognition of national measuring etalons and of the issued calibration certificate;</p> <p>1.4. undertake measures to maintain transmittance, in case of damage and destruction of national measurement etalons.</p> <p>2. Technical capability of national measuring etalons laboratories is maintained through participation in international metrological activities and is proved by accreditation or in another equivalent way.</p> <p>3. The department coordinates activities of national measuring etalons laboratories towards international recognition.</p> <p>4. National etalons laboratories shall send information to the departament related to activities with national measuring etalons, including information related to utilization of budgetary funds based on the contract</p>	<p>1.1.osiguranje transmitivnosti (istraživosti) nacionalnih etalona mera sa jedinicama SI;</p> <p>1.2. proširivanje jedinica nacionalnih etalona mera kod referentnih etalona mera i mernih instrumenata putem kalibriranja;</p> <p>1.3. osiguranje međunarodnog priznavanja nacionalnih etalona mera i izdatog certifikata kalibriranja;</p> <p>1.4. preduzimanje mera za očuvanje transmitivnosti (istraživosti), u slučaju oštećenja i uništavanja nacionalnih etalona mera.</p> <p>2. Tehnička mogućnost laboratorija nacionalnih etalona mera se čuva putem učestvovanja u međunarodnim metrološkim delatnostima i isprobava se akreditacijom ili na neki drugi način iste vrednosti.</p> <p>3. Departament ujedinja delatnosti laboratorija nacionalnih etalona mera ka međunarodnom priznanju.</p> <p>4. Laboratorije nacionalnih etalona trebaju slati departament podatke za delatnosti sa nacionalnim etalonima mera, uključujući i podatke za upotrebu budžetskih fondova na osnovu ugovora napravljenog između</p>
--	---	---

<p>të kontratës së hartuar mes tyre.</p> <p style="text-align: center;">Neni 8 Kalibrimi i etalonëve dhe mjeteve matëse</p> <p>1. Kalibrimi i etalonëve dhe mjeteve matëse kryhet konform dokumenteve dhe rekomandimeve të organizatave ndërkombëtare për standardizimin, akreditimin dhe metrologjinë.</p> <p>2. Kalibrimi i etalonëve dhe mjeteve matëse kryhet në laboratorët e kalibrimit, me kërkesën e përdoruesit.</p> <p>3. Rezultatet e kalibrimit dëshmohen me certifikate kalibrimi.</p> <p>4. Me akt nënligjor përcaktohen kushtet që duhet t'i përmbushin laboratorët për kalibrim.</p>	<p>between the parties.</p> <p style="text-align: center;">Article 8 Calibration of etalons and measuring devices</p> <p>1. Calibration of etalons and measuring devices is performed in conformity with documentation and recommendations of international organizations for standardization, accreditation and metrology.</p> <p>2. Calibration of etalons and measuring devices is performed in calibration laboratories by the request of the user.</p> <p>3. Results of calibration shall be testified by a calibration certificate.</p> <p>4. Conditions that are to be fulfilled by calibration laboratories are determined by sub-law acts.</p>	<p>njih.</p> <p style="text-align: center;">Član 8 Kalibriranje etalona i mernih instrumenata</p> <p>1. Kalibriranje etalona i mernih instrumenata se vrši u saglasnosti sa dokumentima i preporukama međunarodnih organizacija za standardizaciju, akreditaciju i metrologiju.</p> <p>2. Kalibriranje etalona i mernih instrumenata se vrši u laboratorijama za kalibriranje, na zahtev korisnika.</p> <p>3. Rezultati kalibriranja se dokazuju certifikatom kalibriranja.</p> <p>4. Pod-zakonskim aktom se određuju uslovi koje trebaju ispuniti laboratorije za kalibriranje.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 9</p> <p>1. Detyrat e laboratorëve të etalonëve shtetëror për të mbështetur transmetueshmërinë (gjurmueshmërinë) e matjeve janë:</p> <p>1.1. te ofrojnë kalibrime të etalonëve referent të matjeve të laboratorëve të</p>	<p style="text-align: center;">Article 9</p> <p>1. Duties of national etalons laboratories to support traceability of measurements:</p> <p>1.1. laboratories of national etalons provide calibration for reference measuring etalons</p>	<p style="text-align: center;">Član 9</p> <p>1. Dužnosti laboratorija nacionalnih etalona za podršku transmitivnosti (istraživosti) merenja.</p> <p>1.1. laboratorije nacionalnih etalona nude kalibriranje referentnih etalona mera</p>

